

Komuna e Lipjanit: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Që nga viti 2007, në dy palë zgjedhje lokale, fitues në garën për kryetar komune dhe asamble komunale kanë dalë Shukri Buja dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK).
2. Nga 31 asambleistë sa janë gjithsej në Kuvendin Komunal, 12 janë nga PDK, nëntë nga LDK, katër nga AKR, dy nga LDD, dy nga AAK, një nga PSDK dhe një asambleist i pavarur, i cili në kohën e zgjedhjeve ka qenë kandidat i subjektit politik ORA. PDK ka arritur koalicion me AKR dhe LDD. Nga 13 drejtori sa ka Komuna e Lipjanit, dy udhëhiqen nga AKR dhe dy nga LDD, ndërsa nëntë drejtoritë tjera udhëhiqen nga PDK.
3. Në regjistrimin e fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, numri i përgjithshëm i banorëve në këtë komunë është 57.605 banorë.¹
4. Në hulumtimin e zhvilluar nga Instituti GAP në fund të vitit 2009, problemet kryesore në Komunën e Lipjanit kanë qenë: mungesa e ngrohjes qendrore për ndërtesat kolektive, mungesa e parkut dhe hapësirave të gjelbëruara, mungesa e sinjalizimit horizontal dhe vertikal nëpër rrugë, kundërmimi nga ferma e pulave si dhe mungesa e përkujdesjes ndaj zonave historike e turistike.²
5. Ndërsa në bazë të hulumtimit të opinionit të qytetarëve në komuna i realizuar nga UNDP më 2012, qytetarët e kësaj komune janë me pak të kënaqur me punën e kryetarit të komunës dhe administratën komunale, në krahasim me përqindjen e kënaqshmërisë në komunat tjera. Kësisoj, 61% në Lipjan janë shprehur të kënaqur me punën e deritanishme me kryeartin e komunës (mesatarja në nivel vendi është 69%).³

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2012. Komuna e Lipjanit Burimi: http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

² Instituti GAP. Komuna e Lipjanit. Raport komunal 2009. Fq 3. Burimi: http://www.institutigap.org/documents/87924_Lipjan-raporti%20komunal.pdf

³ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 90. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216825.pdf

Problemet kryesore në Komunën e Lipjanit

- 1. Ndotja e lumit “Sitnica”.** Lumi kryesor që përshkon komunën e Lipjanit është “Sitnica”. Në të derdhen disa lumenj të vegjël dhe përroska, burimi i të cilave është në malet përreth. Më të rëndësishmet janë lumenjtë “Janjevka”, “Zegorka” dhe “Gadimja”. Gati të gjithë lumenjtë dhe rrjedhat e ujit të komunës janë të ndotura. Ndotja shkaktohet nga hedhja e vazhdueshme e mbeturinave në shtratin e lumit si dhe nga derdhja e kanalizimeve përgjatë vijës së shtretërve të lumenjve. Banorët e fshatit Smallushë dhe Carabreg kanë protestuar me qellim të sensibilizimit të autoriteteve nga gjendja e keqe e cila shkaktohet nga kundërmimi i rrjedhjes së lumit nga papastërtia dhe sasia e madhe e mbeturinave. Hulumtimi i UNDP-së tregon se një përqindje relativisht e lartë e banorëve të Lipjanit janë të shqetësuar me ndotjen e mjedisit në komunën e tyre. Tridhjetë e pesë përqind e tyre, konsiderojnë qytetin e tyre të fëlliqur ose shumë të fëlliqur, kurse 34% pohojnë se lagjja e tyre është e fëlliqur ose shumë e fëlliqur.⁴
- 2. Mungesa e objekteve shkollore.** Në fshatrat Gllogovc, Gumnasellë dhe Krajishtë të Komunës së Lipjanit mungojnë objektet shkollore. Komuna ka nisur në vitin 2010 ndërtimin e këtyre shkollave, por përveç disa punëve sipërfaqësore të kryera, punimet janë ndërprerë dhe që dy vite nuk është punuar asgjë. E papërfunduar ka mbetur edhe salla e sporteve në fshatin Shalë. Hulumtimi i UNDP-së tregon se institucionet më të afërta parashkollore mund të arrihen mesatarisht për 19 minuta (në krahasim me mesataren e Kosovës prej 20 minutash), shkolla më e afërt fillore mesatarisht për 13 minuta (në krahasim me mesataren e Kosovës 14 minuta), dhe shkolla më e afërt e mesme, mesatarisht për 27 minuta (në krahasim me mesataren e Kosovës 25 minuta).⁵
- 3. Gjendja e keqe e objekteve shkollore.** Disa nga objektet ekzistuese të shkollave fillore dhe atyre të mesme në komunën e Lipjanit, janë të dëmtuara. Kjo vërehet edhe nga pamja e jashtme e shkollave, madje edhe në qendër të qytetit. Në gjendje të keqe nga dëmtimet e infrastrukturës (mureve, dritareve, dyerve) është

⁴ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 89. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

⁵ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 88. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

shkolla fillore në fshatin Banullë. Kulmi i kësaj shkolle është përgjithësisht i shkatërruar, ashtu siç vërehen të thyera dritaret dhe dyert e kësaj shkolle. Ngjashëm është gjendja në shkollën “Zenel Hajdini” në fshatin Gadime. Në oborrin e kësaj shkolle ekziston një deponi ilegale për hedhjen e mbeturinave.⁶ Gjendje akoma më e keqe vërehet në shkollën “Vëllezërit Frasheri” dhe në shkollën e mesme “Adem Gllavica” të cilat gjenden në qendër të qytetit. Gjendja në këto objekte nuk ka arritur të përmirësohet edhe përkundër investimeve nga ana e komunës në riparimin e objekteve. Mos menaxhimi i duhur i objekteve shkollore ka sjellë atë gjendje, menaxhim ky i cili bie nën përgjegjësinë e drejtorive të shkollave se bashku me Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Lipjanit. Shkollat e Lipjanit u ekspozohen shpesh edhe vjedhjeve të ndryshme të aseteve brenda tyre.⁷

- 4. Mos mirëmbajtja e ndërtesave publike.** Në qendër të qytetit të Lipjanit, përgjatë rrugës kryesore “Lidhja e Prizrenit” dhe në zonën “Adem Jashari” ekzistojnë disa ndërtesa publike të ndërtuara para viteve ‘90-ta. Këto ndërtesa nuk janë gëlqerosur asnjëherë pas periudhës së luftës, po ashtu nuk kanë ndriçim të jashtëm apo në shkallët e brendshme. Dritaret e korridoreve dhe të shkallëve vërehen të thyera. Banorët në këto ndërtesa kanë shfrytëzuar edhe hapësirat e jashtme, ballkonet, për t’i shndërruar ato në dhoma duke e prishur kësisoj strukturën e ndërtesës. Njësoj është gjendja me ndërtesën në kryqëzimin e rrugës Magurë – Medvec.
- 5. Mungesa e ngrohtores së qytetit.** Kryetari aktual i Komunës së Lipjanit edhe në zgjedhjet e 2007 edhe në ato të 2009 ka premtuar nisjen e objektit dhe instalimin e gypave për shpërndarjen e ngrohjes qendrore në qytetet. Asgjë në këtë drejtim nuk është bërë. Bashkëbiseduesit në këtë komunë e kanë cilësuar këtë si njërin ndër problemet me të cilat përballen banorët veçmas ata që jetojnë në objekte kolektive të banimit.
- 6. Deponitë ilegale të mbeturinave dhe papastërtia në qytet.** Në disa pjesë të qytetit të Lipjanit vërehen grumbuj mbeturinash të hedhura. Gjendja më e keqe paraqitet në zonën e quajtur “Mostina”. Në këtë komunë ekziston edhe një deponi e madhe ilegale në zonën mes kryqëzimit Magurë dhe Kerqer. Në këtë zonë janë të hedhura dhe vazhdojnë të hidhen mbeturina në mënyrë të pakontrolluar dhe në formë ilegale. Kjo deponi kundërmon dhe rrjedh ujëra të zeza të cilat shpërndahen në zonat e banuara duke shkaktuar kësisoj telashe të theksuara për banorët dhe tokat e

⁶ Gazeta “Koha Ditore”. 16.03.2013. Ndotja rrezikon 200 mije euro investim në shkollën “Zenel Hajdini” në Gadime. Burimi: <http://www.kohaditore.com/?page=1,31,138964>

⁷ Gazeta “Koha Ditore”. 04.01.2013. Aktet vandale në dy shkolla të Lipjanit. Burimi: <http://www.koha.net/?page=1,4,129773>

tyre. Nga shkalla e madhe e ndotjes përballen edhe banorët e fshatit Medvec. Kjo ndotje shkaktohet nga gurthyysi i cili gjendet në mes të këtij fshati. Nga hulumtimi i opinionit të qytetarëve i realizuar nga organizata “DEMI/USAID, 53% e qytetarëve të Komunes së Lipjanit janë shprehur të pakënaqur me gjendjen ekologjike në komunën e tyre.⁸

Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur dhe ruajtur

- 1. Parku nacional “Blinaja”.** Njëri ndër vendet më atraktive në Komunën e Lipjanit paraqitet parku i shpallur nacional “Blinaja”. Ky park mbulon një hapësirë rreth 60 hektarë dhe është i mbjellë kryesisht me drunjë të pishës. Bashkëbiseduesit nga kjo komunë kërkojnë që ky park të mirëmbahet, të rregullohet rruga për shëtitjen e qytetarëve, të bëhet vendosja e shportave të vogla për hedhjen e mbeturinave të imta si dhe të vendoset ndriçimi publik.
- 2. Shpella e Gadimes.** Krahas parkut nacional “Blinaja”, në Komunën e Lipjanit gjendet edhe Shpella e Gadimes. Ekziston vetëm një shenjë orientuese që të lehtëson marrjen e drejtimit ka kjo shpellë. Për shumë vite Shpella është menaxhuar nga persona privat. Qeveria e Kosovës kishte marr vendim⁹ në mars të 2009 që Shpella e Gadimes të vihet nën përkujdesje institucionale, mirëpo ky vendim nuk është zbatuar ende në tërësi.
- 3. Shtëpia e Stefan Gjeqovit në Janjevë.** Aktualisht kjo shtëpi është pa mirëmbajtje dhe shpesh herë shfrytëzohet nga njerëz të pa strehë. Autoritetet nuk kanë ndërmarr ndonjë nismë apo plan në konservimin dhe restaurimin e saj. Bashkëbiseduesit kanë kërkuar që kjo shtëpi të vihet nën mbrojtjen e Komunës.


⁸ Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshmerinë e qytetarëve me shërbimet komunale 2012. Fq 37. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf

⁹ Qeveria e Kosovës. Vendimi nr.04/57, 13 mars 2009. Burimi: http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_57_-te_te_Qeverise_2009.pdf

Trendet Buxhetore në Komunën e Lipjanit

Në vitin 2013 Komuna e Lipjanit ka 12 milion euro buxhet. Krahasuar me vitin 2010, buxheti i kësaj komune është rritur për 2.6 milion euro (28%). Pas një ngritje të të hyrave vetanake në vitin 2011, këto të hyra në vitin 2012 kanë shënuar rënie prej 459 mijë euro dhe në total kanë qenë 1.1 milion euro.¹⁰ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm¹¹ ka konstatuar se komuna ka nevojë për planifikim më të mirë të të hyrave si dhe në vendosjen e mekanizmave më efektive për inkasim. Në vazhdim, ZAP-i ka gjetur këto parregullsi: a) pasqyra jo-të plota financiare; b) nga 12 rekomandime të auditorit në vitin e kaluar, vetëm 4 janë adresuar plotësisht; c) rishqyrtim rrënjësor i fushës së prokurimit; d) pranimi i parregullt i 66 punëtorëve të arsimit etj.

Figure 1. Buxheti i Komunës së Lipjanit 2013




Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?lipjan/2013>

¹⁰ Ministria e Financave, Raporti Vjetor Financiar për Vitin që Përfundon më 31 Dhjetor 2012,
¹¹ ZAP, Raporti i Auditimit mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Lipjanit për Vitin e Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 07 Gusht 2013, http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KLIP_2012_Shqip_976662.pdf

Në bazë të grafikomit mbi ndarjet buxhetore shohim se pas një rritje të shpenzimeve kapitale në vitin 2011, ato kanë pësuar rënie prej 506 mijë euro (12%) në vitin pasues. Në anën tjetër shpenzimet për “mallra dhe shërbime” pritet të rriten për 457 mijë euro (38%).

Figura 2. Trendet e ndarjeve buxhetore 2010-2013



Në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2014-2016 shohim se buxheti Lipjanit pritet të shënoj ulje në 2014, mirëpo në vitet në vazhdim pritet të kthehet trendi i rritjes duke u bazuar në rritjen e grantit qeveritar dhe të hyrave vetanake. Kjo rritje do të reflektohet në rritjen e shpenzimeve në kategoritë e “pagave dhe mëditjeve”, “mallrave dhe shërbimeve” dhe “shpenzimeve kapitale”.

Tabela 1. Planifikimi i të Hyrave dhe Shpenzimeve 2014-2016

Të hyrat	2014	2015	2016
Të hyrat totale	11.182.425	11.487.474	11.731.211
Të hyrat vetanake	1.166.927	1.201.935	1.225.974
Grantet	10.015.498	10.285.539	10.505.237
Shpenzimet Totale	11.182.443	11.487.474	11.761.211
Pagat dhe Mëditjet	6.800.000	7.002.500	7.209.462
Mallrat dhe Shërbimet	976.642	1.011.651	1.065.690
Shërbimet Komunale	256.500	256.500	256.500
Subvencionet TTTransferet	200.000	200.000	200.000
Shpenzimet Kapitale	2.949.301	3.016.823	3.029.559

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorimin e fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulumtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Lipjanit është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP janë mbështetur me të dhënat kuantitative të siguruara përmes anketës së zhvilluar nga ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.